

Maqedonia: Me hapa të pasigurt drejtë Evropës

I. PASQYRË E PËRGJITHSHME

Vendimi i Bashkimit Evropian, i marrë në Samitin e dhjetorit 2005, që Maqedonisë t'i jepet statusi i kandidatit për anëtarësim në BE është një moment historik për këtë vend në rrugën drejtë integritimeve evropiane. Por, karakteri i paqartë i këtij vendimi, që nuk cakton një datë se kur do të fillojnë bisedimet për anëtarësim, tregon se vendi ende përballë me sfida praktike e politike për të ndërnuar një demokraci stabile post-konfliktuale. Implementimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, që i dha fund një lufte të shkallës së ultë në vitin 2001, është afër kompletimit dhe reformat esenciale janë në realizim e sipër, megjithatë ky progres sado sinjifikant që është, është edhe relativ. Bashkësia ndërkombëtare duhet të vazhdojë të bëjë presion mbi qeverinë që të bëjë hapa më të shpejtë dhe më seriozë në sektorët vitalë, përfshirë policinë e veçanërisht gjyqësinë, ku ende ka ngecje e ku realizimi konkret shpesh është më i ngadalshëm se sa retorika e qeverisë.

Ashtu sikur që kishte ndihmuar njohja e Maqedonisë me emrin e saj kushtetues nga ana e SHBA-së në nëntor të vitit 2004, njësoj edhe vendimi i BE-së i dha shtytje të rëndësishme prestigjit dhe vetëbesimit të vendit. Megjithatë, fjalët e zgjedhura me kujdes në Samit tregojnë se BE-ja do të vazhdojë të bëjë presion, gjë që vërtetë duhet ta bëjë, për më shumë përparim në disa fronte. Arsye për shqetësim, sidomos për reformat në polici dhe gjyqësi, kanë edhe qytetarët e zakonshëm të Maqedonisë si edhe liderët e tyre politikë. Përparimi në këto sfera jo vetëm që është parakusht për anëtarësim në BE por ndikon drejtpërdrejtë edhe në aftësinë e koalicionit që të qeverisë në mënyrë të përgjegjshme.

Reformat policore, të përcaktuara nga Ohri, kanë shënuar përparim në aspekt të rekrutimit dhe trajnimit të kadetëve të rinj, duke shtuar numrin e oficerëve shqiptarë dhe duke marrë përgjegjësinë për ruajtjen e kufijve. Por, derisa qeveria nuk shkon më larg dhe të prekë çështjet menaxheriale më fundamentale, përfshirë decentralizimin e përgjegjësi dhe të institucionalizojë një sistem të gradimit në bazë të meritave, policia nuk do të jetë shërbim transparent e i përgjegjshëm që u shërben qytetarëve.

Sistemi gjyqësor mbetet i pareformuar dhe jofunksional. Vendi me 2 milion banorë ka rreth 1,2 milion raste të pashqyrtuara. Ky sistem i gjymtë që pëson me të madhe

nga ndikimi i ekzekutivit dhe korrupsioni, i shërben interesave të ngushta politike. Bashkësia ndërkombëtare e ka vërejtur këtë problem vonë, vetëm atëherë kur sistemi gjyqësor filloi të kërcënojë përparimin e bërë në fushat tjera. Qeveria ka përpiluar disa amendamente kushtetuese që synojnë të promovojnë pavarësinë e gjyqësorit, përfshirë emërimet e përjetshme dhe nevojën e marrjes së shumicës, dy të tretat e votave në parlament, për t'u emëruar. Por tani duhet edhe të implementojë këto masa dhe të ndërmarrë hapa të menjëhershëm që të përmirësojë kualitetin dhe të shtojë përgjegjësinë duke larguar gjyqtarët e korruptuar dhe të papërgjegjshëm si dhe duke trajnuar ata që janë të kualifikuar dhe të aftë.

Dy gjëra tjera, që nuk janë të lidhura me njëra tjetrën, kërkojnë vëmendje të veçantë në vitin 2006. Kthimi në skenë i katër rasteve të krimeve të luftës të hetuara nga Tribunali i Hagës kërcënon të kthejë kujtimet e hidhura nga konflikti i vitit 2001 dhe të sfidojë sistemin gjyqësor joadekuat. Mënyra se si do të veprohet në këto raste – në aspektin operacional dhe politik – do të ndikojë në politikën vendore si dhe në marrëdhëniet e Maqedonisë me partnerët ndërkombëtarë. Shtimi i tensioneve përbrenda komunitetit islam, ku gara për lidhësi ka tejkalluar suazat e çështjes së institucionit dhe tani ka kapluar edhe opinionin publik, ka bërë që të shtrohet pyetja nëse vendi kërcënohet nga islamizmi radikal. Nuk ka kërcënim të vërtetë vahabit por liderët e shqiptarëve të Maqedonisë brengosen se lufta për pushtet mund të reflektohet keq në komunitetin e tyre dhe do të mund të keqpërdoret nga armiqtë politikë.

Edhe pse shqetësimet që kulmuan me referendumin e nëntorit 2003 – duke numëruar këtu edhe shqetësimet rreth asaj se si do të bëhej ndarja e pushtetit ndër komunitetet etnike si dhe paraqitja jetëshkurtër e një grupi të armatosur shqiptar në periferi të Shkupit – duken tanimë të tejkaluara, Maqedonia ende mbetet një demokraci e papjekur, e prekshme nga keqdashësit që kërkojnë t'i keqpërdorin reformat e papërsosura. Rruga drejt Evropës do të jetë e sigurt vetëm atëherë kur vendi do të implementojë iniciativat e nevojshme dhe do t'i menaxhojë sfidat politike para se këto të shndërrohen në kriza. Këta janë disa nga hapat e nevojshëm:

- **Gjyqësia.** Bashkësia ndërkombëtare dhe Maqedonia duhet të angazhohen që të bindin Tribunalin e Hagës që të shtyjë së paku deri në gjysmën e dytë të vitit 2006 (më së miri deri më

2008) kthimin e katër rasteve që po shqyrton derisa donatorët të punojnë me qeverinë që të shpejtojnë reformën e gjyqësorit, përfshirë mbajtjen e trajnimeve të veçanta për gjyqtarët që merren me krimet serioze; teknikat e hetimeve në vendin e ngjarjes; një program funksional të mbrojtjes së dëshmitarëve; dhe një gjykatë për krimet serioze. Pasi të jenë miratuar amendamentet kushtetuese, qeveria duhet që menjëherë të lirohet nga gjyqtarët e korruptuar dhe ata të dobët, të themelojë një gjykatë të re administrative për shkeljet më të lehta të ligjit, dhe të themelojë një akademi të përhershme për gjyqtarët dhe prokurorët e ri.

- **Policia.** Ligji për policinë që ende pret të miratohet, duhet që të delegojë më tepër, e jo më pak, kompetenca në rajonet policore. Njësisë për Standarde Profesionale duhet t'i shtohen personeli dhe resurset (përfshirë edhe prezencën e BE-së) ashtu që të jetë në gjendje të hetojë korrupsionin dhe keqpërdorimet përbrenda policisë, si dhe të zhvillohet praktika e avancimit në karrierë në bazë të meritave dhe kjo praktikë të zbatohet me shpejtësi në rastin e oficerëve më të dalluar. Gjithashtu, policia duhet të koordinojë më për së afërmi punën e vet me agjencitë tjera qeveritare.
- **BE.** Duke përfutur nga personeli dhe përvoja e misioneve të mëparshme, Proxima dhe EUPAT, Brukseli duhet të vejë një mision të ri, nga qershori 2006, me resurse më të mëdha financiare e njerëzore. Raportimi para Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE) duhet të zgjerohet dhe të përfshijë tërë sektorin e gjyqësisë, përfshirë punën e gjyqtarëve, prokurorëve dhe të burgjeve. Duhet të dërgojë këshilltarë në Ministrinë e drejtësisë dhe të punëve të brendshme, në Zyrën e prokurorit publik si dhe në stacionet e reja rajonale të policisë. PSBE duhet të punojë me qeverinë që të emërojë një këshilltar për çështjet e gjyqësisë dhe punëve të brendshme në Zyrën e kryeministrit që do të ishte përgjegjës për përshpejtimin e reformave dhe koordinimin mes ministrive dhe organeve tjera qeveritare.

II. DËRGESA I KTHEHET DËRGUESIT: RASTI I KRIMEVE TË LUFTËS

Në shtator të vitit 2002, qeveria maqedone i dorëzoi juridiksionin mbi pesë rastet e padive për krime lufte Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (Tribunali i Hagës). Në akuzën e fundit të bërë publike, në mars 2005, Tribunali ka akuzuar ish-ministrin e brendshëm, Ljube Boshkovski, dhe truporin e tij, Jovan Tarqullovski, për krime lufte të kryera në fshatin

Luboten. Gjykimi është caktuar të fillojë në vitin 2006, por sipas kushteve të dakorduara në margjina të marrëveshjes paqësore të Ohrit dhe pas pajtimin nga ana e Tribunalit, në prill 2005, katër rastet për të cilat Tribunali nuk ka ngritur padi, do t'i kthehen Maqedonisë në një datë që ende mbetet të caktohet. “Riatdhesimi” i këtyre rasteve paraqet sfidë serioze politike e procedurale për Maqedoninë dhe bashkësinë ndërkombëtare.¹

Këto raste janë hapur që në gusht të vitit 2001, kur Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK) e Ali Ahmetit negocioi kushtet e çarmatimit me Sekretarin e Përgjithshëm të atëhershëm të NATO-s, George Robertson. Marrëveshja mes tyre – e bërë ndarë nga korniza politike që në të njëjtën kohë negocihohej nga liderët politikë të Maqedonisë në Ohër – ishte esenciale për zyrtarët e Maqedonisë pasi siguroi përkrahjen e UÇK-së për marrëveshjen paqësore dhe trasoi rrugën për operacionin Korra Esenciale, misionin e NATO-s për grumbullimin dhe shkatërrimin e armëve të kryengritësve pasi këta i kishin dorëzuar ato vullnetarisht.² Në kuadër të marrëveshjes, qeveria maqedone u zotua të amnistojë kryengritësit shqiptarë, përveç atyre që kanë kryer krime lufte. Në mars të vitit 2002 në lidhje me këtë u miratua një ligj që përcakton edhe se “procedura kriminale nuk do të ngrihet as kundër atyre që kanë kryer vepra kriminale të lidhura me konfliktin e vitit 2001 e që bien nën juridiksionin e Tribunalit si dhe kundër atyre kundër të cilëve ka vepruar Tribunali”.³

Në kohën kur NATO e kishte arritur marrëveshjen për çarmatim me UÇK-në dhe qeveria e kishte miratuar ligjin për amnisti, Tribunali tashmë e kishte përmyllur dekadën e parë të punës së vet. Duke pasur parasysh kufizimet kohore dhe në resurse, si dhe shkallën më të ultë të këtyre krimeve në krahasim me konfliktet tjera në

¹ Boshkovski and Tarqulovski akuzohen për vrasje, shkatërrim të paarsyeshëm të qyteteve e fshatrave dhe trajtim çnjerëzor. Katër rastet tjera janë: i) “Udhëheqësia e UÇK-së”, që ka të bëjë me dhjetë pjesëtarë të lartë të UÇK-së të cilët dyshohen se kanë marrë pjesë në “krime serioze”; ii) “Rezervuari ujqor i Likovës”, që ka të bëjë me ndërprerjen e furnizimit me ujë qytetit të Kumanovës, duke lënë gati 100.000 banorë pa ujë të freskët për disa javë; iii) “Punëtorët rrugorë në Mavrovë” që ka të bëjë me kidnapimin e pesë punëtorëve rrugorë në zonën rreth fshatit Grupçin; dhe iv) “Neproshten”, që ka të bëjë me varrezën masive në fshatin Neproshten të Tetovës. Shih Rasti numër IT-02-55-MISC.6.4, tetor 2002 në <http://www.un.org/icty/misc/decision-e/28115138.htm> (në gjuhën angleze).

² Për më tepër detaje për “Korra Esenciale” shih <http://www.nato.int/fyrom/tfh/home.htm> (në gjuhën angleze), si dhe komentet e Sekretarit të Përgjithshëm të bëra në konferencën për gazetarë më 14 shtator 2001, në <http://www.nato.int/fyrom/tfh/2001/t010914a.htm> (në gjuhën angleze).

³ Ligji për amnisti, 7 mars 2002, Neni 1.

rajon, Tribunali nuk ishte i entuziazmuar me faktin se do të merrej edhe me raste tjera nga rajoni dhe “pak a shumë qe shtyrë nga NATO-ja që të merret me to”.⁴ Ali Ahmeti nuk ishte i gatshëm që të nënshkruajë një marrëveshje që i jepte gjykatave të Maqedonisë juridiksionin mbi krimet e luftës, ndërsa bashkësia ndërkombëtare nuk ishte e gatshme që t’i amnistonte këto krime. Duke e futur në këtë mes Tribunalin, NATO e mbajti fjalën që ia kishte dhënë Ahmetit për ta bindur që të pranojë çarmatimin: se asnjë akuzë për krime lufte nuk do të ngrehet në Maqedoni dhe asnjë gjykim i tillë nuk do të mbahej në Maqedoni. “Ne kemi nënshkruar një marrëveshje me bashkësinë ndërkombëtare për këtë, në formë të marrëveshjes me NATO-n. Ne e kemi një marrëveshje”, insiston Ahmeti, i cili tani është kryetar i Unionit Demokratik për Integritet (UDI), partia politike kryesore shqiptare në koalicionin qeverisës.⁵

A. INTERPRETIMET E NDRYSHME TË LIGJIT PËR AMNISTI

Me njoftimin se aktakuza kundër Boshkovskit e Tarqulovskit është e fundit e Tribunalit dhe me konfirmimin se rastet tjera do t’i kthehen Maqedonisë, implikimet praktike e politike të ligjit për amnisti – nëse dhe si do të zbatohet – janë vënë në qendër të vëmendjes. Politikanët kanë filluar t’i matin gjërat. Kryeministri Buçkovski ka thënë se “varësisht nga faza në të cilën janë këto raste... është dëshirë e jona që të ndërmarrim diçka në së paku dy prej tyre... Duhet të nisim proceset për rastet e kidnapimit dhe zhdukjes së maqedonëve e shqiptarëve”.⁶ Në anën tjetër, zëdhënësi i partisë së tij

tërhoqi vërejtjen se “një vendim do të merret nga ekspertët dhe institucionet kompetente. Politikanët nuk duhet të bëjnë deklarata dhe vlerësime për shkak se këto raste janë shumë të politizuara”.⁷ Ahmeti, që ka qenë dukshëm i heshtur në lidhje me këto raste për shkak të pozitës së tij si ish-UÇK, i ka thënë Grupit të Krizave: “Do të kishte qenë mirë sikur Haga të mbyllë këto raste. Kemi bërë një kërkesë politike që asnjë nga këto raste të mos kthehet”.⁸ Tutje, pozicioni i Ahmetit është që vetëm njëri rast – ai i kidnapimit të pesë punëtorëve në rajonin e Mavrovës – të vazhdohet të procesohet pasi “tri rastet tjera bien nën autoritetin e ligjit për amnisti”.⁹

Çuditërisht, konsensusi rreth zbatimit të ligjit për amnisti nuk haset as nën mbështetësit ndërkombëtarë të Maqedonisë. NATO insiston që ligji për amnisti i mbulon edhe katër rastet që do të kthehen nga Haga dhe se marrëveshja e vitit 2001 mes NATO-s, BE-së dhe OSBE-së ende është e zbatueshme. Megjithatë, kolegët e tyre nga BE-ja dhe diplomatët perëndimorë ia lënë çdo interpretim autoriteteve relevante maqedone. Siç thotë njëri prej tyre, “ne nuk jemi kompetentë që të interpretojnë ligjin për amnisti, as për të mirë as për të keq. Qeveria duhet të masë mirë dhe të marrë një vendim sa më të drejtë”.¹⁰ Një tjetër thotë, “Janë dërguar si raste (të dyshimta); do të kthehen (nga Haga) si raste (të dyshimta e nën hetime). I takon Maqedonisë që të veprojë ashtu siç mendon se është më së miri”.¹¹ Pa ndonjë pozicion apo udhëzim zyrtar, disa zyrtarë ndërkombëtarë në Shkup kanë shprehur bindjen e tyre personale se ligji nuk i mbulon këto katër raste prandaj Maqedonia është e obliguar që t’i procedojë këto.¹²

B. KOHA PËR TË BËRË NJË STRATEGJI

Edhe pse qeveria është e preokupuar me agjendën e reformave, duhet që të gjejë kohë e të përqendrohet edhe në këtë çështje. Ministri i drejtësisë së shpejti do të takohet përsëri me zyrtarët e Tribunalit që të merren vesh rreth procesit që “ende duhet të vendoset”.¹³ Për Tribunalin, këto procese si dhe çështja e kohës kur vijnë në skenë janë çështje relativisht triviale, megjithëse këto

⁴ Intervistë telefonike e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar, 28 tetor 2005. Sipas Rezolutave 1503 dhe 1534 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Zyra e Prokurorit duhej të përmblynte hetimet për rajonin deri në fund të vitit 2004. Zyra e Prokurorit thotë se, megjithatë, “fundi i mandatit për hetime nuk do të thotë edhe fund i Tribunalit... janë edhe dy afate tjera në strategjinë e përmblyjes: 2008 dhe 2010”, <http://www.un.org/icty/briefing/2005/PB050316.htm> (në gjuhën angleze). Shih edhe deklaratën e zëdhënësit të TPNJ-së gjatë konferencës së përjavshme me gazetarë, 25 maj 2005: “Përveç hetimeve që kanë mbetur të përmblyen, asnjë nga të dyshuarit nuk ka arritur nivelin e përgjegjësisë që kërkohet që të lëshohet padia pasi nuk ka fakte të mjaftueshme për t’i lidhur ata me krimet e kryera”.

⁵ Intervistë e Grupit të Krizave me Ali Ahmetin, Tetovë, 1 nëntor 2005.

⁶ Në janar 2005, kryeministri Buçkovski ka deklaruar: “Historia e vonë e Maqedonisë do të jetë e shtrembëruar nëse Haga heton vetëm një të vetmin rast”. Kjo deklaratë u përsërit edhe nga kryetari Cërvenkovski. Shih “Kryeministri Buçkovski: E palogjikshme të ketë aktakuzë vetëm për Lubotenin”, Agjencia e Lajmeve Makedonija, 20 janar 2005, dhe “Buçkovski thotë se Maqedonia planifikon të veprojë në së paku ‘dy raste’ të kthyera nga TPNJ-ja”, Radio Makedonija, 17 qershor 2005.

⁷ Zëdhënësi i LSDM-së, Boris Kondarko, në “Dnevnik”, 27 prill 2005.

⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me Ali Ahmetin, Tetovë, 15 nëntor 2005.

⁹ Ibid.

¹⁰ Intervista të Grupit të Krizave me përfaqësues ndërkombëtarë, Bruksel, 28 tetor 2005, dhe Shkup, 14 nëntor 2005.

¹¹ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar, Shkup, 9 nëntor 2005.

¹² Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë ndërkombëtarë të sigurisë, Shkup, 9 dhe 14 nëntor 2005.

¹³ Intervistë e Grupit të Krizave me Ministrin e Drejtësisë, Meri Mladenovska, Shkup, 14 nëntor 2005.

kanë implikime serioze për Maqedoninë që nuk dëshiron që të vihen në pikëpyetje garancat që u janë dhënë në vitin 2001 liderëve shqiptarë. Përveç kësaj, nëse rastet kthehen para zgjedhjeve parlamentare që do të mbahen në vitin 2006, rreziku është që krejt kjo punë të shndërrohet në një “futboll” politik. Për më tepër, pas zgjedhjeve lokale dubioze (prill 2005), BE-ja do të vëzhgojë me më shumë kujdes se si do të zhvillohet fushata e zgjedhjeve dhe vet zgjedhjet.¹⁴ Logjika thotë se do të ishte në interesin më të mirë të të gjithëve që Tribunali të shtyjë kthimin e këtyre rasteve deri pas zgjedhjeve. Megjithatë, përveç se të shqetësohet rreth asaj se kur do të kthehen këto raste, qeveria duhet të përpilojë edhe një strategji se si të adresojë çështjen e amnistisë, rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare relevante si dhe fushatën e informimit publik.

Derisa qeveria punon në përpilimin e strategjisë, partnerët e Maqedonisë duhet të bëjnë të njëjtën dhe të arrijnë një pozicion unik rreth ligjit për amnisti. Shqetësimet për atë se disa do të mbeten “të paprekur” duhet të adresohen me kohë, përndryshe ekziston rreziku që të merret nëpër këmbë përkushtimi i bashkësisë ndërkombëtare që të merret me krimet e luftës dhe, më gjerë, përkushtimi që të ruhet ligji humanitar ndërkombëtar. Partnerët e Maqedonisë duhet të luajnë një rol të rëndësishëm duke ndihmuar, për shembull: qeverinë që të njoftojë opinionin publik për rrjedhën e proceseve; që të themelojë gjykata speciale dhe kapacitetet gjyqësore; për trajnimet e shpejta për përgatitjen e prokurorëve, avokatëve dhe gjyqtarëve; si dhe në ngritjen e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve. Shumë nga këto do të ishin edhe ndihmë afatgjate në reformimin e përgjithshëm të gjyqësisë.

Kthimi i këtyre rasteve nga Tribunali është i paevitueshëm. Një plan koherent, i zhvilluar nga qeveria dhe i mbështetur nga bashkësia ndërkombëtare, ka më shumë gjasa që të tregojë seriozitetin e këtyre aktorëve në sytë e Tribunalit dhe ndoshta ta inkurajojë që të shtyjë për një kohë kthimi duke lejuar që të zbatohen në praktikë reformat e nevojshme gjyqësore.¹⁵

¹⁴ Zgjedhjet e ardhshme në Maqedoni do të jenë për parlamentin e vendit dhe do të mbahen në fund të vitit 2006.

¹⁵ Maqedonia ka pasur një gjykim për krime lufte në vend: në vitin 2003, Ibrahim Sulejmani është dënuar nga një gjykatë maqedone për krime lufte të kryera në vitin 2001 në Drenovë. Ai është dënuar me 15 vite burg dhe ende është duke u mbajtur në burg.

III. REFORMA GJYQËSORE DHE PAKËNAQËSITË ME TË

Problemet e Maqedonisë me çështjet e krimeve të luftës hedhin dritë mbi mangësitë e mëdha që ekzistojnë në sistemin juridik të vendit. Përkundër kësaj, sektori i gjyqësisë është i bindur se ka mjaft kapacitete që të merret me punët që ia dorëzon Tribunali. “Maqedonia ka kapacitet që të merret me këto katër raste”, e ka siguruar Grupin e Krizave kryetari i Këshillit Republikan.¹⁶ “Kemi juristë kompetentë dhe të gjitha rastet do t’u dorëzohen gjyqtarëve me përvojë gjegjëse. Implementimi dhe suksesi nuk do të jenë problem”.¹⁷ Edhe pse koleget e saj në Ministrinë e drejtësisë pajtohen, fjalët e tyre janë më të matura. Ministrja Mladenovska thotë se “ne jemi duke i mësuar gjyqtarët për ligjin humanitar, jemi duke i reformuar ligjet – ne do të merremi me këto raste”.¹⁸

Megjithatë, ka zyrtarë në ministritë relevante si dhe në koalicionin qeverisës që, jozyrtarisht, shprehin shqetësimin e tyre në lidhje me kapacitetet e vërteta të degës së gjyqësisë. Një zyrtar i lartë këmbëngulë: “(Këto raste) nuk mund të trajtohen fare! Nuk kemi klimën e duhur politike si dhe kemi një sistem gjyqësor shumë joprofesional”.¹⁹ Ndërsa, edhe pse ka shumë mospajtime mes ndërkombëtarëve rreth çështjes së amnistisë, shumica prej tyre pajtohen se “gjyqet thjeshtë nuk janë gati”, “reformat në gjyqësor janë barazi me zero” dhe se “gjyqtarët thjeshtë nuk janë të gatshëm që të bëhen mbrojtës të rendit kushtetues”.²⁰

Që një kohë të gjatë gjyqësia konsiderohet joefikase, e korruptuar dhe e nënshtruar ndikimeve politike.²¹ Edhe

¹⁶ Organi aktualisht përgjegjës për zgjedhjen, disiplinën dhe shkarkimin e gjyqtarëve.

¹⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me Lence Sofronievskaja, kryetare e Këshillit Republikan, Shkup, 14 nëntor 2005.

¹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me Ministrën e Drejtësisë, Meri Mladenovska, Shkup, 14 nëntor 2005.

¹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të lartë të qeverisë, Shkup, 4 nëntor 2005.

²⁰ Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë ndërkombëtarë në Bruksel dhe Shkup, 28 tetor 2005 dhe 14 nëntor 2005.

²¹ Disa raste të profilit të lartë tregojnë me çfarë vështirësisë përballen gjyqësori. Rasti më i dalluar, i raportuar më parë nga Grupi i Krizave, është ndoshta rasti i vrasjes së gjashtë pakistanezëve dhe një indiani, në mars 2002, të cilët ishin kapur nga policia maqedone në kufirin me Bullgarinë duke udhëtuar me pasaporta false. Pasi i kishin mbajtur në paraburgim për disa ditë, ata qenë dërguar në një vend të pabanuar dhe ishin vrarë ndërsa u ishin vënë “fakte” që duhej të tregonin se këta të shtatët ishin terroristë që ishin nisur të bombardonin ambasadat perëndimore në Shkup. Përkundër fakteve të shumta, në maj të vitit 2005 gjykata i shpalli të pafajshëm tre policë dhe një biznesmen që akuzoheshin me vrasjen e këtyre të shtatëve.

pse reformat përkrahen nga zyrtarët, legalizohen nga burokratët dhe ndërkombëtarët ofrojnë trajnime, implementimi praktik i reformave gjyqësore mbetet në fazat fillestare. Përveç sfidave që hasen në të gjithë sektorët e jetës publike në vend, janë edhe disa faktorë unikë që i kanë kontribuar kësaj gjendjeje. Së pari, Marrëveshja Kornizë e Ohrit, bazë e reformave pas konfliktit, nuk ka prekur gjyqësinë²² dhe progresi ka ngecur nga preokupimi i qeverisë me mandatin e Ohrit, interesimin e përgjithshëm të politikanëve që të heqin dorë nga ndikimi që kanë mbi gjyqësinë si dhe mungesa e “udhëzimeve” të qarta ndërkombëtare.²³ Mungesa e shoqërisë civile të zhvilluar që do të përqendrohej në reformën e gjyqësorit është edhe një pjesë tjetër që i mungon mozaikut. Hapja e perspektivës për anëtarësim në BE – dhe shprehja e shqetësimeve me kapacitetet juridike të vendit nga ana e BE-së – më në fund kanë bërë që të arrihet konsensusi politik, iniciativa dhe ndërmarrja e disa hapave.

Pakënaqësia e thellë me gjyqet është diçka që haset shpesh ndër qytetarët e Maqedonisë si dhe ndër zyrtarët e diplomatët, dhe kjo duhet të shfrytëzohet për të bërë presion mbi vendimmarrësit politikë që të bëjnë ndryshimet e nevojshme. Ngecja në reforma ka krijuar një situatë në të cilën vendi me dy milion banorë ka gjyqe që ende presin t’i shqyrtojnë 1,2 milion raste. Rastet në të cilat janë të përfshirë ata me lidhje të forta politike e financiare janë shumë të ndikuara nga jashtë. Shkarkimi i paradokohshëm i disa gjyqtarëve ka bërë pak që të heqin frikën se “qytetarët kanë pak gjasa që të kenë gjykim të lirë nga ndikimet politike”.²⁴ Për më tepër, procedurat e

përditshme gjyqësore janë të paralizuara nga sistemi joefikas i seancave, mbrojtjes në liri dhe të shpalljes së aktgjykimeve; nga prokurorët e korruptuar, nga një qark vicioz i mosparaqitjeve në gjyq dhe vonesave, si dhe nga mungesa e sigurisë për zyrtarët e gjykatave dhe dëshmitarët. Trajnimet e pamjaftueshme dhe mungesa e perspektivës për avancim profesional, mungesa e përgjithshme e respektit për procedurat dhe shprehja e gjykatave që të fajësojnë të tjerët dhe të ankohen se janë të pafuqishëm që të bëjnë diçka, kanë krijuar një situatë në të cilën sistemi mezi bën ndonjë hap përpara.

Në nëntor të vitit 2004 – edhe atëherë me trysni të mëdha nga jashtë – për herë të parë Maqedonia publikoi strategjinë kombëtare për reforma gjyqësore.²⁵ Strategjia për Reforma në Sistemin Gjyqësor” cakton orarin e përmirësimeve ligjore e funksionale që synojnë të avancojnë pavarësinë dhe efikasitetin. Pasi u sigurua miratimi i parlamentit për amendamentet kushtetuese, në maj 2005, Ministria e drejtësisë morri përsipër që të përpilojë amendamentet dhe provizionet tjera legale. Tani është duke finalizuar amendamentet ndërsa ka siguruar edhe miratimin e disa paragrafëve të disa ligjeve kryesore.

Pakoja e amendamenteve dhe ligjeve përmban edhe provizionet për zgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve; përbërjen e Këshillit Republikan; mekanizmeve për të zvogëluar ngecjet në procedimin e rasteve që kanë të bëjnë me pakicat; mbrojtjen e dëshmitarëve, konfliktin e interesit; si dhe komisionin për anti-korrupsion. Megjithatë, grindja që ka lindur rreth dy çështjeve – shumicës parlamentare të nevojshme për emërimë nëpër gjykata si dhe kohëzgjatja e shërbimit për gjykatësit – ka zbuluar dallimet mes retorikës politike dhe gatishmërisë për të vepruar. Në kundërshtim me këshillat e ekspertëve të jashtëm (të cilët më pas janë shkarkuar) draftet e para të qeverisë parashihnin vetëm një shumicë të thjeshtë parlamente, jo dy të tretat siç rekomandohej, për emërimin e gjyqtarëve për një “periudhë provuese” në vend se të jenë emërimë për tërë jetën. Me këtë, qeveria mendohej të mbante ndikimin e shtyllës ekzekutive mbi

Rastet tjera që ia vlen të përmenden janë edhe përmjekja jokompetente e “peshkopit” Jovan Vraiskovski dhe rastet e korrupsionit të përmendura nga Ambasada amerikane (mund të gjenden në <http://skopje.usembassy.com>) Shih edhe raportin e CEELI-t të shkurtit 2005 rreth shqetësimeve të SHBA-së me “prolongimin e paarsyeshëm” të rasteve të korrupsionit, <http://www.abanet.org/ceeli/countries/macedonia/feb2005.htm> si dhe vlerësimin analitik të BE-së (avis) për kandidaturën e Maqedonisë, faqe 23, që mund të gjendet në http://www.delmkd.cec.eu.int/en/whatsnew/2005/sec_1425_final_en_analytical_report_mk.pdf

²² Marrëveshja e Ohrit mandaton reforma sinjifikante në polici, qeverisje të decentralizuar, financa dhe Zyrën e Avokatit të Popullit apo Ombudsmenit. Shih Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, Aneksi B, Modifikimet e Legjislativit, që mund të gjendet në <http://www.european-defence.co.uk/keydocuments/ohrid.pdf>

²³ Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 149, *Maqedonia: Nuk ka vend për kënaqësi*, 23 tetor 2003, faqe 15: “Nuk ka pajtim ndër donatorët dhe shoqërinë civile në Maqedoni sa i përket problemeve më serioze në gjyqësi. Shumica e fondeve shkojnë për shtim të kapaciteteve, paga dhe trajnim e jo në ndërtimin e pavarësisë së gjyqësorit”.

²⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me Mirjana Najcevska, kryetare e Komitetit të Helsinkit, Shkup, 11 nëntor 2005.

²⁵ “Strategjia e Reformave në Sistemin Gjyqësor” në http://www.vlada.mk/english/Assets/Strategy%20JUDICIAL%20SYSTEM/1.STRATEGY%2011-ANG_koregirana.doc. Janë dy faktorë që e kanë detyruar qeverinë që të kalojë nga fjalët në vepra. Disa muaj pasi Maqedonia ka dorëzuar përgjigjet në pyetësonin e BE-së dhe kur aplikimi për anëtarësim po shqyrtohej, Brukseli ka kritikuar ashpër përparimin në këtë çështje. Qeveria ishte shqetësuar sepse në pyetje ishte kandidatura. Dhe derisa partnerët tjerë ndërkombëtarë vazhdonin të bënin presion për reforma, SHBA-ja publikoi listën e rasteve të korrupsionit për të cilat ishte e brengosur. Qeveria i miratoi disa ligje esenciale, përfshirë, për shembull, Ligjin për Buxhet të Pavarur të Gjykatave (i miratuar më 2003) që i dha gjykatave më shumë kontroll mbi përpilimin dhe alokimin e buxhetit të vet. Burim jozyrtar për më shumë informata: <http://www.courtmodernization.com/publications.htm>.

gjyqësinë. Ajo lëshoi pe vetëm pas intervenimit të bashkësisë ndërkombëtare.

Edhe pse është motori i vërtetë i reformave gjyqësore, bashkësia ndërkombëtare në fillim nuk ka pa vepruar në mënyrë të koordinuar e gjithëpërfshirëse. Sikurse edhe qeveria, partnerët ndërkombëtarë ishin më të preokupuar me implementimin e marrëveshjes së Ohrit dhe angazhimi i tyre në fillim vetëm sa prekte sipërfaqen e reformës gjyqësore.²⁶ Kur u bë e qartë se një gjyqësor i pareformuar kërcënon progresin edhe në fushat tjera, përfshirë policinë, zhvillimin ekonomik dhe luftën kundër korrupsionit, ata filluan të bëjnë presion mbi qeverinë që të përqendrohet në këtë çështje. Tani, me pak progres në frontin e legjislacionit, vëzhguesit ndërkombëtarë e vlerësojnë me nota mesatare punën e Ministrisë së drejtësisë. Megjithatë, mbetet dyshimi në aftësinë e Ministrisë që të qojë çështjen deri në fund. “(Ministria) thjeshtë nuk është shembull bindës i reformimit”, është shprehur një diplomat i brengosur sidomos për ndikimin që kjo do të ketë në investimet e drejtpërdrejta ndërkombëtare. Një tjetër nënvizoi se “reforma e gjyqësorit është reduktuar në ndryshim të ligjeve... ndërsa askush nuk është duke i zbatuar ato”.²⁷

Zyra e prokurorit publik ka rol të rëndësishëm edhe në promovimin e reformave gjyqësore që realizohet duke luftuar korrupsionin. Ajo duhet të bashkohet me entitetet relevante shtetërore, veçanërisht me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.²⁸ Por, pas emërimit të tij

²⁶ Shih Brifingun për Evropë të Grupit të Krizave numër 33: *Maqedonia: Pajtim ose hidhërim*, 3 gusht 2004, që thotë: “Ironikisht, NATO – një organizatë politiko-ushtarake – ka qenë më e zëshmjja ndër aktorët ndërkombëtarë në këtë çështje. Në mbledhjet e nivelit të lartë në shtabin qendror në Bruksel, NATO ka drejtuar kritika të ashpra në drejtim të liderëve të Maqedonisë për dështimet në luftimin korrupsionit. Tash së voni, Komisioni Evropian ka treguar interesim të shtuar”. Në ndërkohë, donatorët ndërkombëtarë – veçanërisht Komisioni Evropian, OSBE-ja dhe USAID – kanë ndërmarrë projekte që, për shembull, kanë për synim trajnimin e gjyqtarëve dhe zyrtarëve të gjykatave, që të sigurojnë pajisje teknike për përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave dhe përfshirjen e OJQ-ve dhe qytetarëve në procesin e reformimit të gjyqësisë.

²⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, Shkup, 16 nëntor 2005.

²⁸ Në nëntor 2002, në bazë të Nenit 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit, i miratuar në prill 2002 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 28 të vitit 2002), Komisioni Kombëtar për Parandalimin e Korrupsionit është themeluar si entitet i pavarur përgjegjës për zhvillimin e planit veprues në nivel kombëtar për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, monitorimin e implementimit të planit dhe raportimin e progresit para parlamentit. Ky plan ka veçuar “koordinimin e pamjaftueshëm mes Zyrës së Prokurorit Publik dhe aktorët tjerë në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”. Shih [në këtë post, në janar 2003, prokurori publik Aleksandër Përçevski ka hedhur poshtë të gjitha kërkesat e Komisionit për t’u takuar dhe rivaliteti mes institucioneve u bë çështje publike nëpërmjet mediave.²⁹ Në nëntor 2005, kur vendet anëtare të BE-së debatuan kandidaturën e Maqedonisë, kryeministri Buçkovski i detyroi Përçevskin dhe kryesuesin e Komisionit, Dragan Malinovski, që të takohen, por mbetet të shihet nëse vërtetë do të mbahen takimet tjera, siç janë zotuar.](http://spai-rslo.org/documents/</p></div><div data-bbox=)

Shumë e përfolura përkrahje e qeverisë për reformat e gjyqësorit ka mbetur e kufizuar në punën e detyrueshme të negociimit, përpilimit dhe miratimit të kornizës ligjore, me në krye Ministrinë e drejtësisë, që ka punuar intensivisht që të përgatisë pesëdhjetekatër ligjet që përbëjnë programin e qeverisë për reformën e gjyqësorit (që do të mbikëqyrin reformën e mëtutjeshme). Megjithatë, në një sistem ku, siç vërejtji një zyrtar ndërkombëtar, “ligji është vetëm një sugjerim”, qeveria duhet të trajtojë legjislacionin e ri si hapin e parë të rëndësishëm e jo si përfundim.³⁰ Pasi ligjet dhe amendamentet kushtetuese kryesore janë miratuar deri në fund të vitit 2005, gatishmëria e qeverisë për të bërë hapa tjerë shumë shpejtë do të mund të shihet. Përmirësimet jokonstraverse duhet që të implementohen menjëherë.³¹ Nëse qeveria seriozisht dëshiron që të ndërtojë një sistem gjyqësor profesional, të aftë dhe të përgjegjshëm, që e meriton besimin e qytetarëve, do të veprojë që të qojë deri në fund rastet e njohura të korrupsionit që shpesh përmenden nga BE-ja de SHBA-ja. Ky duhet të jetë fillimi i një pune të koordinuar që të çrrënjoset korrupsioni, patronazhi politik dhe mosefikasiteti në gjyqësi. Në ndërkohë, paralelisht me këtë duhet të punohet që të kultivohet profesionalizmi ashtu që një entitet i veçantë të ofrojë arsimim dhe trajnim të specializuar për 654 gjyqtarët, prokurorët dhe stafin tjetër të gjykatave të Maqedonisë, ngjashëm me atë siç bën academia policore për oficerët e policisë.

macedonia/strategy/SCPC%20 ANTICORRUPTION%20 PROGRAMME.doc.

²⁹ Prokurori Publik ka akuzuar Komisionin për hetime me motive politike dhe përzierje në çështjet ekzekutive, përfshirë komentet e Komitetit parlamentar për sistemin politik, më 16 maj 2005, në lidhje me punën e Zyrës së Prokurorit dhe kritikën e tij për Komisionin. Shih, për shembull: “Sekerinska: institutions battling corruption to coordinate”, (Shekerinska: Institucionet që luftojnë korrupsionin të koordinohen) *Makfax*, ora 14:40, 29 qershor 2005; “Slagana Taseva: Përçevski obstructs the fight against corruption”, (Slagana Tasev: Përçevski pengon luftën kundër korrupsionit), *Dnevnik*, 23 maj 2005; dhe Zoran Andonovski, “Facilitators and billygoats” (Ndimeçarët dhe penguesit), *Vreme*, 29 nëntor 2005. 3.

³⁰ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar në Shkup, 10 nëntor 2005.

³¹ Për shembull, themelimi i një gjykate të veçantë administrative për t’u marrë me shkeljet më të vogla.

Disa nga aktorët mbajnë përgjegjësinë kryesore për reformën e gjyqësorit – përfshirë këtu gjyqet dhe udhëheqësin e Këshillit Gjyqësor Republikan, Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën e Prokurorit Publik – por edhe aktorët tjerë të shtetit kanë obligimet e veta. Për shembull, të jemi më të saktë, botimi me kohë, i saktë, dhe bërja publike e Gazetës Kombëtare, si dokument zyrtar i teksteve juridike, do të shtonte njohuritë për ligjet e rëndësishme.³² Parlamenti ka autoritet mbikëqyrës dhe mundet të organizojë seanca publike për kandidatët për postet e larta në gjykata. Në vend se të shfrytëzojnë proceset parlamentare që debatet për ligjet t'i kthejnë në “luftë mes partive politike”, siç e ka karakterizuar procesin një zyrtar ndërkombëtar, parlamentarët duhet që të përdorin autoritetin e tyre në mënyrë më adekuate, për shembull duke kërkuar raporte për hapat e ndërmarrë nga dega e ekzekutivit dhe duke hapur hetime për punën e gjyqësisë në rastet e korrupsionit.³³ Në ndërkohë, një shoqëri civile e organizuar, që synon të luajë një rol më të madh në promovimin e reformës së gjyqësorit në Maqedoni, duhet të përfitojë nga përpjekjet për të shtuar, për shembull, transparencën dhe përgjegjësinë e institucioneve gjyqësore dhe përfaqësuesve të tyre, duke monitoruar dhe publikuar progresin e qeverisë në implementimin e reformës, si dhe duke siguruar trajnim të specializuar për zyrtarët gjegjës qeveritarë.³⁴

Partnerët ndërkombëtarë mbesin të brengosur me mundësinë që progresi të jetë vetëm afatshkurtër. “Është vështirë që të shihen zgjidhje afatshkurta apo afatmesme”, shprehet i shqetësuar një zyrtar.³⁵ Në thelb, problemet kanë të bëjnë me moshën... Nuk mund t'ua ndërrosh mënyrën e të menduarit 75 për qind të gjyqtarëve”, thotë një tjetër.³⁶ Megjithatë, nëpërmjet çfarëdo kombinimesh, OSBE-ja, BE-ja dhe vendet individuale duhet të ndihmojnë Maqedoninë që të zhvillojë një strategji që së bashku të shtyjë qeverinë që të godasë korrupsionin dhe

patronazhin politik brenda gjyqësisë derisa në të njëjtën kohë ofron këshilla të drejtpërdrejta, udhëzime e trajnime. Duke nxjerrë mësim nga sukseset në reformat në polici dhe mbrojtje, bashkësia ndërkombëtare duhet të punojë me qeverinë që të ofrojë programe trajnimi, të institucionalizuara, për gjyqësinë dhe të ngrejë mekanizma “të ndërlidhur” që vënë ekspertë ndërkombëtarë, të dërguar enkas, përkrah zyrtarëve gjyqësorë me të cilët do të punonin në çift, duke u ofruar udhëzime profesionale, trajnim teknik si dhe një shkallë të njëfarë mbikëqyrjeje. Nëse qeveria vazhdon të angazhohet vetëm me fjalë e jo edhe me vepra, përparimi i arritur deri tani do të avullohet shumë shpejtë.

IV. REFORMA POLICORE

Për dallim nga reformat në gjyqësi që tash vonë janë bërë prioritet i qeverisë, angazhimet për të reformuar policinë datojnë që nga koha e marrëveshjes paqësore e vitit 2001. Marrëveshja e Ohrit obligon qeverinë që të themelojë, trajnojë dhe shpërndajë në tërë vendin një forcë policore më të larmishme etnikisht si dhe të inkuadrojë komunitat në procesion e zgjedhjes së shefave të policisë.³⁷ Planet e mëvonshme si dhe legjisllacioni kërkojnë që, përveç ngritjes së kritereve për pranim në forcë, të bëhen reforma në nivelin menaxherial që të ndërtohet një sistem i bazuar në merita, një sistem vendim-marrës më i decentralizuar, që të delegohen kompetenca dhe përgjegjësi si dhe në përgjithësi të shtohet transparenca dhe përgjegjësia.³⁸ Resurset dhe kujdesi që i është kushtuar themelimit të një shërbimi policor modern, profesional dhe multi-etnik kanë dhënë rezultate, ndërsa pikëpamjet e ndryshme që vijnë nga të gjitha anët më së miri përmbledhen në deklaratën e liderit shqiptar, Ali Ahmeti, i cili thotë: “Ka disa ndryshime pozitive, por ka edhe shumë punë për t'ua bërë”.³⁹

Në sipërfaqe, të arriturat duken impulsive. Me përkrahje të konsiderueshme nga jashtë, qeveria ka shtuar përfaqësimin e shqiptarëve të Maqedonisë në polici, ka trajnuar mijëra oficerë policie dhe ka vënë patrulla multi-etnike në vendet ku jetojnë pakicat. Ministria e Brendshme ka marrë përgjegjësinë e plotë për kontrollimin e kufirit; ka themeluar akademinë policore, njësinë kundër krimit të organizuar dhe drejtorinë e emergjencave; ka vënë mekanizma për kontakte me komunitetet me qëllim që të

³² Gazeta Kombëtare është publikim i përditshëm që përmban tekstet e ligjeve federale, dokumentet presidenciale, rregulloret administrative dhe njoftimet, si dhe përshkrimet e organizatave, programeve dhe aktivitetet e tyre. Shih: <http://www.vlada.mk>

³³ Shkëmbim me postë elektronike i Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar, 10 janar 2006. Më 30 maj 2005 parlamenti mbajti – deri tani të vetmen – seancë publike të mbikëqyrjes. Ministri i ambientit dhe planifikimit fizik qe ftuar që të tregojë para Komitetit për Transport, Komunikacion dhe Ambient, për të arriturat e ministrisë së tij në përmbushjen e rregulloreve të BE-së. Seanca është transmetuar në kanal televiziv të parlamentit.

³⁴ Për shembull, Fondacioni Instituti për Shoqëri të Hapur në Maqedoni (Foundation Open Society Institute Macedonia) dhe Iniciativa për Ligj në Evropën Qendrore dhe Euroazi (Central European and Eurasian Law Initiative – CEELI).

³⁵ Intervistë e Grupit të Krizave me zyrtarë ndërkombëtarë të sigurisë, Shkup, 8 nëntor 2005.

³⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar, Shkup, 10 nëntor 2005.

³⁷ Shih: Marrëveshja Kornizë e Ohrit, Aneksi C, Masat për implementim dhe ndërtim të besimit, paragrafi 5.

³⁸ Shih: Strategjia Kombëtare për Reforma në Polici (miratuar në shkurt 2004) dhe plani i veprimit i dalë nga ajo (miratuar në janar 2005).

³⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me Ali Ahmetin, Tetovë, 15 nëntor 2005.

inkurajojë bashkëpunimin e qytetarëve.⁴⁰ Sa i përket strukturës menaxheriale, ka përpiluar planet strategjike dhe për veprim; ka përpiluar Ligjin për policinë si dhe planin operacional për emërimin e shefave rajonalë të policisë; si dhe ka themeluar Njësinë për Standarde Profesionale. E ka përmirësuar edhe komunikim dhe bashkëpunimin mes sektorit gjyqësor dhe me Ombudspersonin Kombëtar. Ministri Mihajlovski, në besim, thotë: “Reformat në Ministrinë e brendshme janë në fazën e fundit dhe planifikojmë që t’i përmbylim deri kah fundi i vitit”.⁴¹ Megjithatë, një vlerësim i sinqertë duhet të marrë parasysh edhe kualitetin e reformave të bëra si dhe atë se çfarë nuk është bërë.

Përpjekjet e para të Ministrisë që të adresojë mosefikasitetin institucional kanë qenë hapa modestë në drejtimin e duhur por implementimi në dy binarë – programor dhe menaxherial – ka qenë më i dyshimtë. Marrëdhëniet e tensionuara mes ministrit, të emëruar nga LSDM-ja, dhe zëvendësit të tij, lojalist i BDI-së, jo vetëm ilustrojnë problemet por edhe përkeqësojnë sfidat menaxheriale dhe ndikojnë në zgjerimin e humnerës mes progresit taktik, siç janë masat për të profesionalizuar dhe përzier etnikisht rangjet, dhe reformimin e nivelit menaxherial.⁴² Implementimi i projekteve në bazë, në terren, është jo-

⁴⁰ Ministria e punëve të brendshme mori përgjegjësinë për kontrollimin e kufijve nga Ministria e mbrojtjes dhe ka bashkuar njësitë e shpëtimit (nga fatkeqësitë natyrore dhe çminim) me brigadën e zjarrfikësve.

⁴¹ Guner Ismail, “Nuk ekziston më rreziku i shpërthimit të krizës së madhe ndëretnike”, *Forumi i Shkupit*, 1 korrik 2005, fq. 34-41.

⁴² Raportet e Ministrit Mihajlovski me përfaqësuesin e partnerit shqiptar në koalicionin qeveritar – veçanërisht me zëvendësm ministrin Fatmir Dehari – janë të dalluara si të këqija dhe tregojnë për mosgatishmërinë e tij që të decentralizojë autoritetin e ministrisë si dhe të bashkëpunojë me entitetet e jashtme, përfshirë edhe Avokatin e popullit. Për shembull, në qershor 2005, Mihajlovski refuzoi që të paraqesë para parlamentit propozimin e qeverisë për emërimin e komandantëve të policisë, që ishte dakorduar mes kryeministrit Buçkovski dhe liderit të BDI-s, Ahmeti. Buçkovski qe detyruar të prezantojë dhe mbrojë vetë propozimin. Në të njëjtën kohë, Mihajlovski me sukses ka luftuar emërimin e kandidatit të preferuar të BDI-së për zëvendës-drejtor të shërbimit sekret, post ky i liruar pasi Dehari qe avancuar në zëvendës-ministër. Ky post ende është i zbrazët. Zyrtarë ndërkombëtarë dhe të qeverisë si edhe mediat ankohen për marrëdhëniet e ngrira mes dy zyrtarëve më të lartë të ministrisë. Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë ndërkombëtarë për çështje të sigurisë si dhe zyrtarë të qeverisë, Shkup, 8-14 nëntor 2005. Shih dhe Diana Mladenovska, “Ministri i brendshëm i Maqedonisë ‘kërcënohet’ me dorëheqje për shkak të ligjit për policinë”, *Vreme*, 24 qershor 2005, fq. 3; Fami Bajrami “Ahmeti bën presion për ndërrimin e Xhango, ky konteston kuadrot e BDI-së”, *Koha Ditore*, 8 qershor 2005, fq. 5; dhe “Shqiptarët të injoruar nga kolegët maqedonë, Xhango përçmon Deharin”, *Koha Ditore*, 23 prill 2005, fq. 1, 4.

konsistent dhe me kualitet të ndryshueshëm. Edhe pse të dhënat e fundit statistikore mbështesin përshtypjet e opinionit publik se ka një rënie të përgjithshme të krimit në rrugë (veçanërisht në kryeqytet), raportet për sjellje të vrazhdë të policisë dhe akuzat për lidhje me interesat kriminale bëjnë që të shtrohet pyetja nëse dhe si oficerët e policisë e shfrytëzojnë trajnimin që kanë marrë.

Qeveria shpesh thekson rolin e rëndësishëm që luajnë dy njësi nga kadri i ministrisë në çrënjosjen e korrupsionit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut: Njësia e Krimit të Organizuar dhe Njësia e Standardeve Profesionale. Kjo e dyta, e themeluar më 2003, ishte hapi i parë i Ministrisë drejtë institucionalizimit të mbikëqyrjes së brendshme. Mandati i saj origjinal përfshinte vetëm çështjet administrative e disiplinore, por me inkurajimin e parterëve ndërkombëtarë, mandati iu zgjerua që të përfshijë edhe korrupsionin e policisë dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Derisa rastet e hetimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut mbesin pezull apo i lirojnë policët nga përgjegjësia, hetimet për korrupsion në vitin 2004 kanë sjellë shkarkimin e tetë oficerëve të policisë dhe të dy zyrtarëve të Ministrisë si dhe të degradimit të 70 policëve të trafikut.⁴³

Njësia e Krimit të Organizuar është themeluar në muajin janar të vitit 2005. Edhe pse gjatë pjesës më të madhe të vitit nuk kishte zyre, kompjuterë e as vetura, zyrtarët i dhanë një vend të dalluar në aplikacionin për anëtarësim në BE dhe vazhdojnë të trumbetojnë për rolin e kësaj zyre në “përpjekjet e përhershme dhe gjithnjë e më të mëdha që të luftohet korrupsioni”.⁴⁴ Por, edhe pse ka fakte që tregojnë se qeveria është duke u marrë më seriozisht me korrupsionin, është ende herët që të flitet për një fushatë të mirëfilltë.

Mekanizmat e Ministrisë për të luftuar korrupsionin dhe keqtrajtimet komplementohen me punën mbikëqyrëse të Avokatit të Popullit. Këto entitete shpeshherë bashkëpunojnë në rastet që kanë të bëjnë me çështje administrative. Megjithatë, hetimet e paradokohshme të Avokatit të Popullit për shkeljet e mundshme të bëra nga policia kanë bërë që marrëdhëniet mes institucioneve të acarohen. Ministria akuzon ombudsmrin se “po keqpërdorë institucionin publik të Avokatit të Popullit që të pengojë punën e policisë”.⁴⁵ Por, refuzimi i Ministrisë

⁴³ Për më shumë detaje shih raportin e Departamentit të Shtetit të SHB-s-së për të drejtat e njeriut për vitet 2003 e 2004, <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2003/27852.htm>.

⁴⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me zyrtarë ndërkombëtarë, Shkup, 14 nëntor 2005. Shih adresimin e kryetarit para ambasadorëve të vendeve anëtare të NATO-s, 6 prill 2005, në: http://www.vlada.mk/english/speeches/April_2005/speech6-4-2005.htm (në gjuhën angleze).

⁴⁵ Deklaratë e Goran Pavlovski, zëdhënës i ministrisë, dhënë gazetares Nada Maricic, të “Radio Makedonija”, 19 shtator 2005.

që të lejojë qasjen në dokumentacion përmendet vazhdimisht nga ndërkombëtarët si qëndrim i kundër me atë të pohuar nga qeveria se e përkrahë mbikëqyrjen nga jashtë. “(Ministria) nuk është e gatshme që të bashkëpunojë me dikë tjetër, me ministrinë tjera, OJQ-të apo me mediat”, tregon një këshilltar i lartë qeveritar,⁴⁶ ndërsa një tjetër thotë se thirrja në Ligjin për qasje në Dokumentet Sekrete është një lojë me kërkesat e Ombudsmenit.⁴⁷ “Shikoni – konkludon një i tretë – (Ministria) thjeshtë nuk të pranojë një mbikëqyrje efikase”.⁴⁸

Alergjia e Ministrisë ndaj mbikëqyrjes është e shoqëruar me mosgatishmërinë instiktive dhe gjithëpërfshirëse që të delegojë kompetenca tek komunat. Debatimi për zgjedhjen dhe emërimin e shefave të policisë – një element i rëndësishëm i Marrëveshjes së Ohrit – është mjaft i ndikativ. Edhe pse ekziston një qartësi relative rreth procesit të zgjedhjes dhe nominimit të kryesuesve të policisë, ende nuk ka një marrëveshje për demarkacionin e rajoneve policore. Propozimi aktual i Ministrisë do të ndante Maqedoninë në tetë rajone, secila me shefin e vet të policisë, por që, megjithatë, ka tendencë të mbajë pjesën më të madhe të kompetencave në nivelin qendror. Një propozim tjetër, i përkrahur nga BDI-ja e shqiptarëve etnikë, parasheh formimin e 34 njësisve me mesatarisht 15 komuna secila. BDI vlerëson se kjo do të promovonte angazhimin dhe bashkëpunimin e komunitetit, ndërsa propozimi i Ministrisë vetëm sa do të ruante qendrën burokratike të pushtetit. “Ky nuk është problem etnik”, thotë Ahmeti. “Kjo ka të bëjë me menaxhmentin”.⁴⁹ Një zyrtar evropian pranon mosgatishmërinë e Ministrisë që të bëjë decentralizimin: “Burokratët e nivelit të mesëm (në Ministri) vetëm sa i kanë përforcuar postet dhe asgjë serioze nuk është ndërmarrë që të adresohet kjo çështje”.⁵⁰

Mungesa e transparencës në çështjet e personelit në polici, përfshirë transferimet, avancimet dhe degradimet është gjithëpërfshirëse dhe përherë përmendet si sfida

⁴⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të lartë të qeverisë, Shkup, 4 nëntor 2005.

⁴⁷ Në këtë kontekst, zyrtari përmendi ligjin për punën e Avokatit të Popullit dhe Ligjin për qasje në informatat sekrete, që është “miratuar në vitin 2004 nga dëshira për t’u anëtarësuar në NATO, por tani po shfrytëzohet si shkak për të mos dhënë informata”. Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar, Shkup, 9 nëntor 2005. Ligji i ri i propozuar për Lirinë e informimit është kritikuar se nuk i përmbush standardet ndërkombëtare. Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile, 12 janar 2006.

⁴⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar evropian, Shkup, 8 nëntor 2005.

⁴⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me Ali Ahmetin, Tetovë, 15 nëntor 2005.

⁵⁰ Intervistë e Grupit të Krizave me një politikan ndërkombëtarë, Shkup, 8 nëntor 2005.

afatgjate por me implikime imediate. “Koncepti i meritokracisë është krejtësisht i huaj”, shpjegon një zyrtar i cili tregon edhe se si është bërë transferimi i kontrollit të kufirit nën kontrollin civil.⁵¹ Nuk është ky i vetmi që ankohe. Pa gjasa për të përparuar në karrierë në bazë të meritave dhe pa një program për avancim të shpejtë të më të mirëve, Ministria vazhdon që të përkrahë sistemin jofunksional të bazuar në patronazh e jo talent. Kjo i shërben disa agjendave politike por i dëmton angazhimet për të rekrutuar, trajnuar dhe për të pasur në terren një shërbim policor profesional që gëzon besimin dhe bashkëpunimin e komunitetit.

A. ROLI I BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE

Ndihma e bashkësisë ndërkombëtare ka qenë kritike në shtytjen përpara të reformave në polici dhe do të vazhdojë të mbetet e rëndësishme në ngritjen e standardeve të policisë në nivele të standardeve evropiane. Përveç përkrahjes bilaterale, OSBE-ja ka ofruar trajnime fillestare dhe të specializuara për mijëra kadetë që nga viti 2001. Me punën e drejtpërdrejtë, Misioni policor i BE-së (Proxima) ka qenë një nga mekanizmat këshillëdhënës më efikasë. Që nga dhjetori i vitit 2003 ka punuar me menaxhmentin e mesëm dhe të lartë që të “monitorojë, drejtojë dhe këshillojë” policinë dhe zyrtarët e ministrisë për metodat, praktikat dhe koordinimin.

Proxima është entiteti i vetëm multilateral që ka qenë në gjendje të përfitojë nga dëshira e Maqedonisë për t’u anëtarësuar në BE dhe që ka gëzuar një raport të përhershëm bashkëpunimi. Forca e saj ka qenë mundësia që të punojë së afërmi me entitete qeveritare, që t’i bëjë këto të bisedojnë dhe bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Një nga iniciativat më efikase ishte institucioni i takimeve të rregullta të zyrtarëve të Zyrës së Prokurorit Publik dhe Ministrisë së brendshme. Duke u përqendruar në situatat reale, përfshirë aspektet legale dhe operacionale të hetimeve, mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së dëshmitarëve, këto dy entitete filluan që të komunikojnë dhe bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Edhe pse me kufizime, kjo ndihmon autoritetet për mbrojtjen e ligjit që të përqendrohen në qëllimet e përbashkëta në vend se të humbin kohë duke fajësuar njëra tjetrën për mosfunksionim.⁵²

Mandati i Proxima-s ka përfunduar më 15 dhjetor 2005; është zëvendësuar nga Ekipi Këshillëdhënës për Policinë i

⁵¹ Kjo çështje, e transferimit të kontrollimit të kufirit, është përmendur gati nga secili zyrtar i intervistuar nga Grupi i Krizave për reformat në polici. Njëri vërejtje se Armata transferoi shumë eprorë maqedonë ndërsa mbajti ushtarët nga pakicat. Me këtë shtoi figurat për përfaqësimin e pakicave në armatë por duke zvogëluar ato në polici.

⁵² Intervistë e Grupit të Krizave me zyrtarë ndërkombëtarë, Shkup, 11-14 nëntor 2005.

BE-së (EU Police Advisory Team – EUPAT), mision më i vogël, me mandat deri në qershor 2006. Arsyet për largimin e Proxima-s ishin më tepër burokratike. Maqedonia nuk dëshiron që të kategorizohet si vend që ka nevojë për ndihmë të BE-së që “të menaxhojë krizat”, edhe pse mbetet e interesuar që të adresojë kritikën e BE-së për ngecjet në reformën e policisë. Me pajtimin që të vazhdohet misioni i Proxima-s, edhe pse tani me një fytyrë tjetër, EUPAT paraqet një zgjidhje të përkohshme burokratike që i jep BE-së kohë që të organizojë dhe financojë plotësisht një mision tjetër pasues.

Megjithatë, nga aspekti afatshkurtër, statusi i përkohshëm i EUPAT-it do të thotë se ka më pak resurse njerëzore, që do të mund të rezultonte me ngadalësim të hovit të reformave, që pat mundësuar Proxima, ndonëse EUPAT mund të përfitojë nga personeli i Proxima-s dhe nga riorganizimi dhe konsolidimi i tërë autoritetit të BE-së në vend në Përfaqësuesin Special (EURS).⁵³ PSBE (EURS) duhet të jetë në gjendje që të shfrytëzojë dëshirën e Maqedonisë që të përmbushë standardet për anëtarësim dhe të shtyjë Ministrinë e brendshme që të reformohet, gjë që disa thonë se Proxima nuk mund ta bënte me efikasitet.

B. RRUGA PËRPARA

Derisa EUPAT dhe EURS vazhdojnë të punojnë, BE-ja duhet të bëjë presion mbi qeverinë që të bëjë dhe me shumë se sa vetëm të kalojë testin dhe për këtë BE duhet të përgatisë një mision të mirëfilltë që do të vihet në vend më vonë që do të ishte një EUPAT Plus. Mandati i këtij misioni duhet të jetë që të vazhdojë përparimin e arritur me mund, siç është forcimi i bashkëpunimit mes policisë dhe prokurorëve, dhe të mos kufizohet duke bërë të njëjtën gjë. Përkundrazi. Duhet të zgjerohet fushëveprimin dhe të përfshijë masat shitesë siç janë zgjerimi i projekteve për “dyfishim” që vendosin ekspertë përkrah zyrtarëve nëpër ministri dhe nën-njësi; “çiftëzime” nëpër shtabet e rajoneve të policisë; dhe (pasi të jetë tejkaluar lufta rreth emërimeve të shefave të policisë) të caktojë këshilltarë që do të punojnë që decentralizimi të implementohet në zyrat në terren. Një angazhim i tillë do t’i ndihmonte përpjekjet e Maqedonisë që të arrijë standardet e BE-së si dhe do t’i mundësohet Brukselit që të vëzhgojë progresin e kandidatit për anëtarësim.

Që nga viti 2001, “Ministria ka ecur përpara shumë”, thotë një diplomat perëndimor, “në pjesën më të madhe për shkak se nuk ka pasur zgjedhje tjetër, dhe pjesërisht se (Ministri) është i vetëdijshëm për dobitë”.⁵⁴ Reforma policore, edhe pse larg nga të qenët e kompletuar, ka tejkaluar reformën në gjyqësor⁵⁵, por tani kur Maqedonia bën hapa drejt fazës tjetër të anëtarësimit në BE, duhet që të përballet edhe me pakënaqësitë me faktin që “policia po rrezikon jetën vetëm që kriminelët të lirohen (nga gjyqtarët e korruptuar).⁵⁶ Diskutimet për caktimin e një këshilltari ndërkombëtar në nivel të kabinetit për çështjet e drejtësisë dhe punëve të brendshme do të mund të ishin fillimi i një strategjie për të mbyllur këtë hendek, por që ky mekanizëm të jetë i suksesshëm duhet që patjetër të sinkronizohen reformat ashtu që ekspertët e policisë dhe gjyqësisë të mund të bashkëpunojnë në fushat e interesit të përbashkët.

Në ndërkohë, mbetet e papranueshme që, për shembull, për takimin e vetëm deri tani të Prokurorit Publik me kryesuesin e Komisionit Anti-Korrupsion të Qeverisë të nevojitet intervenimi personal i kryeministrit Buçkovski, që Ministria e brendshme t’u ikë hetimeve të Ombudsmenit, dhe që njësitë e specializuara anti-krim të mos koordinojnë detyrat. Derisa bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht PSBE (e potencialisht edhe EUPAT) mund të bëjë më tepër në kryqëzimin e reformave në polici dhe gjyqësi, qeveria duhet të marrë përgjegjësinë për implementimin praktik. Rëndësia e këtyre reformave bëhet më e madhe sa më afër do të jetë anëtarësimi në BE.

V. TË PALARAT E KOMUNITETIT ISLAMIK

Diskutimi për krimin dhe gjendjen e sigurisë nuk mund të jetë i plotë pa prekur edhe debatin e zjartë për infiltrimet e ekstremistëve islamikë në Maqedoni. Gjatë vitit të shkuar, lufta për pushtet në komunitetin islam ka vërshuar opinion publik dhe ka shtuar shqetësimet për një infiltrim të tillë. Çarja e brendshme ka paralizuar Bashkësinë Fetare Islame të Maqedonisë (BFIM), organin udhëheqës të myslimanëve të vendit, duke tërhequr vëmendjen e ndërkombëtarëve si duke u dhënë një shkallë kredibiliteti atyre që thonë se është shtuar influenca e Vahabitëve. Megjithatë, gjasat që fundamentalizmi të lëshojë rrënjë

⁵³ BE-ja ka bërë bashkë postin e Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE) dhe atë të Kryesuesit të Delegacionit të Komisionit Evropian në një post të vetëm, të cilin e mori ambasadori Erwan Fouéré, më 1 nëntor 2005. Ky “bashkëdyzim” është rekomanduar nga Grupi i Krizave në Raportin për Evropë numër 160 “Shqyrtohet aftësi e BE-së për reagim ndaj krizave”, 17 janar 2005, fq. 43.

⁵⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar për çështjet e sigurisë, 8 nëntor 2005.

⁵⁵ Thënë të drejtën, reforma në polici ka qenë më e lehtë pasi është bërë me një dekret të ministrit ndërsa reforma në gjyqësor kërkon para së gjithash pasjen e legjislacionit gjegjës.

⁵⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me Ali Ahmetin, Tetovë, 15 nëntor 2005.

nuk janë reale.⁵⁷ “Është vështirë të dallohen ideologjitë që janë përzier këtu. E tëra mund të jetë vetëm një mospajtim i përgjithshëm”, thotë një vëzhgues i informuar mirë.⁵⁸

Çarja e brendshme u bë publike për herë të parë në tetor 2004 kur reis-ul-ulema (udhëheqësi) i atëhershëm i Bashkësisë Islme të Maqedonisë, Arif Emini, u mor peng nga një grup i imamëve të Shkupit që kërkonin të paguheshin nga udhëheqësi i tyre, Zenun Berisha, i pari i myftijve të Shkupit. Hoxhallarët akuzuan Eminin se kishte lejuar mashtrimin në zgjedhje në të cilat ishte ri-zgjedhur Berisha. Pas pajtimit që të hapet çështja e zgjedhjeve, Emini u lirua menjëherë. Incidenti u bë lajm dhe shërbeu si uverturë në dramën që ende po zhvillohet në komunitetin islamik.

Çështja rreth rizgjedhjes së kontestuar të Berishës dhe përpjekjet e BFIM që të merret me këtë çështje vazhdojnë të zhagiten.⁵⁹ Në maj 2005, Reis-ul-ulema Emini më në fund shkarkoi Berishën dhe u mbajtën zgjedhjet e reja që rezultuan me emërimin në këtë post të Taxhedin Beslimit (që ishte oponenti kryesor i Berishës në zgjedhjet e mëparshme). Por, kampi i Berishës vazhdoi të luftonte për ndikim dhe përkrahësit e tij supozohet se qëndrojnë prapa kërcënimeve dhe incidenteve të dhunshme që kishin për cak Reis-ul-ulemanë.⁶⁰ Kjo ishte e padurueshme për Eminin cili në korrik 2005 dha dorëheqje, tre muaj para se të përfundonte mandatin e tij. Javën tjetër, pesë hoxhallarë janë kidnapuar dhe rrahur nga persona të armatosur në Kondovë, që imamët thonë se janë përkrahës të Berishës

⁵⁷ Për shembull, duke folur për mediat, një imam i sulmuar në Kondovë, është shprehur: Njerëzit që na kanë sulmuar (të shtunën, në Kondovë) janë definitivisht pjesëtarë të islamit radikal, gjegjësisht vahabitë si do t'i quanim ne, që do të përdornin të gjitha mjetet që t'i arrijnë qëllimet. Këta janë pasues të Zenun Berishës synimi i të cilëve, për tani një vit, është që të fusin në dorë BKIM-në. Po të jetë e nevojshme, ata janë të përgatitur për sulme, kërcënime me armë e madje edhe të vrasin, nëse kjo u sjellë atë që dëshirojnë. Shukri Aliu dhe Metini, që janë ndër sulmuesit, kanë hyrë disa herë në zyrën e kryesuesit të Bashkësisë Islme, Haxhi Arif Emini, të armatosur me Kallashnikovë. Ata e bënë këtë përsëri kur me dhunë e ndërprejnë mbledhjen e Bashkësisë islme në Kondovë duke shtënë me armë”. Intervistë me hoxhën e Xhamisë Hudaverli, Shaban Ahmeti, bërë nga Biljana Jovanovska, “Na sulmuan pjesëtarë të Islamizmit radikal”, *Utrinski Vesnik*, 5 korrik 2005, fq. 4.

⁵⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar perëndimor, Shkup, 7 nëntor 2005.

⁵⁹ Për më tepër informata, shih: “Grupi i sabotuesve të Berishës dëbojnë reis-ul-ulema Eminin”, *Makedonija Denes*, 5 mars 2005, fq. 5; “Maqedoni: Myftiu i ri i Shkupit do të zgjidhet pas festës së Bajramit më 20 janar”, *Utrinski Vesnik*, 14 janar 2005, fq. 4; “Komuniteti islam në Maqedoni përballet me ‘çarje të thellë’ rreth zgjedhjes së myftiut të ri”, *Dnevnik*, 4 prill 2005, fq. 1-2.

⁶⁰ Shih: Branko Gjorgjevski, “Myftiu i Shkupit zgjidhet me bomba e kallashnikovë”, *Dnevnik*, 20 qershor 2005, fq. 3.

dhe vahabitë.⁶¹ Tani, pa Reis-ul-ulema që do të kryesonte komunitetin dhe me postin e myftiut të Shkupit ende të kontestuar, asgjë nuk funksionon. Madje edhe kremtimet e festës së Bajramit, në tetor 2005, qenë prekur nga kjo çarje. Në kundërshtim me traditën, Xhamia e Jahja Pashës, e afërt me Berishën, nuk ishte më nikoqire e faljes nga ana e BKIM. Në vend të kësaj, ushtrues i detyrës Reisu-ul-ulema Aliu i siguronte besimtarët në një xhami tjetër se kontesti do të zgjidhej së shpejti.⁶² Vdekja e Jakup Hasipit, myftiut karizmatik të Kumanovës, në janar 2006, në një aksident trafiku, krijon vendin e dytë të lirë ndër trembëdhjetë myftitë e Maqedonisë. Shoqata mund të synojë të zëvendësojë Hasipin, gjë që do të kontestohet nga fraksionet rivale, gjatë zgjedhjes së myftiut të ri të Shkupit, parashikuar të bëhet kah mesi i muajit shkurt të vitit 2006, ndërsa Reis-ul-ulema do të zgjidhet më vonë.⁶³

Përkundër insinuatave se çarja i ka rrënjët në teologjinë religjioze, religjioni përmendet fare pak në diskutimet për problemet e komunitetit. Qasja në pronë, në para dhe ndikimi, janë ato për të cilat luftohet ndërsa religjioni është në plan të dytë. Në bisedimet me zyrtarë të komunitetit, emri “Vahabi” më shumë përdoret për të përshkruar kundërshtarët e udhëheqësisë së BKIM se sa ndonjë ideologji të caktuar. “Kushdo që të jetë myfti i Shkupit, ka pozitën më të fuqishme në tërë komunitetin islam në Maqedoni”, shpjegon Jakub Selimoski, ish-Reis-ul-ulema.⁶⁴ Në fakt, pjesa më e madhe e pronës që pretendon BKIM është në kuadër të myftinisë së Shkupit, e që Berisha e ka menaxhuar për gati një dekadë. Shoqata pohon se shteti ka kthyer vetëm një pjesë të pronës (ankesë kjo e dëgjuar shpesh e nga të gjithë në Maqedoni), por thashethemet dhe akuzat për përvetësim të pronës si dhe për marrëveshje prapashpine ushqejnë spekulimet rreth motiveve të luftës.⁶⁵ Një burim tjetër i të ardhurave

⁶¹ Shih: Igor K. Ilievski, “Rrihen pesë imamë”, *Dnevnik*, 4 korrik 2005, fq. 1, 3. Ngjarja është raportuar edhe në gazetën Lajm, Koha Ditore, Utrinski Vesnik, Vreme dhe Vest.

⁶² Aliu e minimizoi rëndësinë e ndërrimit të vendit: “(Xhamia) Sulltan Pasha është më e madhe, ka më shumë hapësirë dhe mund të zërë më shumë besimtarë”. Intervistë e Grupit të Krizave, Shkup, 11 nëntor 2005.

⁶³ Siç është raportuar në mediat e Maqedonisë më 22 dhjetor 2005. Posti zgjidhet nga 250 imamë të Shkupit.

⁶⁴ Selimoski nuk është vetëm ish-Reis-ul-ulema i BFIM-së por ai ishte edhe Reis-ul-ulema i Bashkësisë Islme në ish-Jugosllavi dhe e ka mbajtur këtë post në Sarajevë deri në vitin 1995.

⁶⁵ Tensionet të ngjashme – që vijnë si rezultat i insinuatave për korrupsion, nga ndërrimi i gjeneratave, lufta për pushtet dhe përdorimi i pasurisë së Bashkësisë – ekzistojnë edhe në Bashkësitë Islme të Bosnjës dhe Sanxhakut. Megjithatë, për dallim nga Maqedonia, kontestet atje kanë edhe përmbajtje të dalluar teologjike. Në Sanxhak, për shembull, disa xhami përdoren nga një grup i vogël i pasuesve të përkushtuar të Vahabizmit. Për më tepër informata shih: Raportin për

është pagesa vjetore për anëtarësim që grumbullohet nga secila xhami, e në të cilat të ardhura BKIM bazohet për pagesën e pagave të imamëve, mbikëqyrjen e objekteve dhe infrastrukturës, si dhe për veprat bamirëse. Reis-ul-ulema Aliu, megjithatë, flet për shtimin e OJQ-ve dhe organizatave tjera që grumbullojnë kontributet në emër të BKIM-së. “Disa nga tensionet e sotme rrjedhin nga ky problem”, thotë Aliu, që njëherë kishte vënë kuotat vjetore të anëtarësisë në përpjekje për të kompensuar mungesat në buxhet.⁶⁶

Derisa Berisha manovron që të mbetet myfti i Shkupit, ka shenja të interesimit nga jashtë për komunitetin islam. “Kur telashet fillojnë – thotë ish-Reis-ul-ulema Selimoski – këto i shfrytëzojnë ‘autsajderat’ me qëllim që të shtohen turbullirat. Ata premtojnë pagesa nëse grupet e caktuar vijjnë në pushtet”.⁶⁷ Gjatë muajit të Ramazanit në TV shfaqeshin spote që promovonin pikëpamje më radikale. Fushata nuk kundërshtohet me mesazhe më të moderuara nga BKIM që thotë se nuk ka para për këtë ndërsa shtron pyetjen se çfarë interesi kanë ata që kanë financuar këtë fushatë.

Vëzhguesit vërejnë edhe se është shtuar numri i femrave të mbuluara në vendet si Tetova, por shtojnë se kjo bëhet sepse ato paguhen për këtë. Edhe pse disa brengosen se një formë më radikale e islamit mund të jetë tërheqëse për popullatën e zonave rurale, ata pranojnë se ky ndikim do të ishte marginal. Me infrastrukturën e komunitetit – përfshirë edhe qendrat arsimore për imamët e ri – të vendosura në apo afër zonave urbane, radikalizmi shikohet si një “sëmundje por jo virus që do të përhapet”, siç u shpreh një vëzhgues perëndimor.⁶⁸

Për dallim nga sistemi politik i patronazhit që mbizotëron gjithandej në sferën politike në Maqedoni, ku lidhjet politike hapin mundësi për punësim dhe biznes, Bashkësia Fetare Islamike e Maqedonisë ka lidhje minimale me partitë politike shqiptare. Edhe pse liderët e Shoqatës shprehen se është me interes që qeveria të jetë më e angazhuar në zgjedhjen e problemeve të tyre, edhe qeveria edhe partitë e koalicionit janë shprehur të rezervuara ndaj kësaj. Në fakt, roli i kufizuar që luajti Ali Ahmeti në procesin zgjedhës së ushtruesit të detyrës së Reis-ul-ulemasë është rezultat i brengës se lufta për pushtet në BKIM po dilte jashtë kontrollit dhe se kjo do të reflektonte keq në komunitetin shqiptar. “Nuk dëshiroja të

inkuadrohesha drejtpërdrejtë”, shpjegon ai, “por isha i gatshëm që të ndihmoja që njerëzit më të mirë të vihen në krye të strukturave të tyre”.⁶⁹ Edhe pse shpesh herë është në konflikt me BDI-në, edhe partia më ekstremiste shqiptare, PDSH-ja, pranon se ndikimi i vahabitëve “mund të ketë efekt negativ në komunitetin shqiptar dhe të jetë hendikep për shqiptarët në Ballkan”.⁷⁰

Derisa postet e rëndësishme mbesin të kontestuara dhe të zbrazëta, qytetarët e Maqedonisë janë lënë me brengën se a mund të preket komuniteti islamik nga ndikimet radikale. Megjithatë, përçarjet janë më tepër rezultat i garës për interesa se sa për ideologji. Është përgjegjësi e organeve të Bashkësisë Fetare Islamike në Maqedoni dhe lidershit të saj që të menaxhojë dhe tejkalojë këtë krizë që po ia pamundëson që të përfaqësojë aktivisht pasuesit e saj, ashtu siç do të duhej. Ndryshe nga ajo që thotë Aliu, gjendja nuk është thjeshtë produkt i mediave sensacionaliste.⁷¹ Kur liderët shëtitin gjithandej me vetura të reja sportive ndërsa imamët nuk i marrin pagat, kur gjenerata më e re kërkon që gjenerata e vjetër të largohet, atëherë kjo do të thotë se këtu ka fërkime. Shteti dhe partitë politike nuk mund të bëjnë shumë në këtë rast.⁷² Derisa qeveria dhe partnerët ndërkombëtarë vëzhgojnë nga distanca, Ahmeti, që për inkuadrimitin e tij thotë se është “i rezervuar por i gatshëm”, mund të jetë i detyruar që edhe një herë të inkurajojë Shoqatën që të mbajë zgjedhje.

VI. KONKLUZIONE

Statusi i sapofituar i kandidatit për anëtarësim në BE për Maqedoninë është mirënjohje për implementimin (gati të plotë) të marrëveshjes paqësore të vitit 2001 dhe shpërblim për të arriturat në reformat demokratike. Implementimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit do të konfirmojë se Maqedonia vërtetë është një shoqëri post-konfliktuale edhe pse kjo marrëveshje nuk qe përpiluar si program gjithëpërfshirës për reforma demokratike. Më parë për qëllim kishte që vendin ta shpijë deri në një pikë kur aspiratat e komuniteteve pakicë nuk do të paraqitnin kërcënim për paqen dhe stabilitetin dhe ku statusi i

Evropë të Grupit të Krizave numër 162, *Serbia's Sandzak: Still Forgotten*, (Sanxhaku i Serbisë: Mbetet i harruar) 8 prill 2005, fq.23-25.

⁶⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, Shkup, 14 nëntor.

⁶⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me Jakub Selimoskin, Shkup, 10 nëntor 2005. Selimoski nuk tregoi se kush janë “ata” por la të kuptohet se po fliste për lokalistët e Berishës.

⁶⁸ Intervistë me një zyrtar perëndimor, Shkup, 7 nëntor 2005.

⁶⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me Ali Ahmetin, Tetovë, 15 nëntor 2005. Ahmeti, larg nga të qenurit xhihadist, siç e paraqesin disa, ka një prejardhje politike militante sekulariste.

⁷⁰ Intervistë e Grupit të Krizave me Sekretarin e Përgjithshëm të PDSH-së, Tetovë, 15 nëntor 2005.

⁷¹ “Ka probleme”, pranon Aliu, “por jam i sigurt se mediat e kanë fryrë dhe thëlluar konfrontimin”. Intervistë e Grupit të Krizave, Shkup, 11 nëntor 2005.

⁷² Ngjashëm, në kontestin mes Kishës Ortodokse Maqedone dhe ish-peshkopit të saj, Jovan Vraniskovski, që ka shpallur aleancë me Kishën Ortodokse Serbe, involvimi i shtetit (veçanërisht në pjesën e gjyqësisë dhe prokurorisë) është përcjell me konfuzion dhe me gabime procedurale.

paqartë i Kosovës më nuk do të paraqiste rrezik për shtetësinë e Maqedonisë.⁷³ Në kontekstin ballkanik, Ohri e vë Maqedoninë në terren të njëjtë apo edhe më të favorshëm se sa fqinjët e saj edhe pse ka edhe shumë rrugë për të bërë para se të mund të konsiderohet shtet mjaft efikase sa të mund të fillonte negociatat për anëtarësim.

Duke veçuar reformat në polici dhe në gjyqësi, BE-ja ka theksuar dy pengesa kryesore. Vëmendja që BE-ja, në vlerësimin e kandidaturës së Maqedonisë (e quajtura “Avis”), i ka kushtuar reformës në polici e ka ngjallur një proces që kishte filluar të zbehej. Për pak vite, policia është transformuar në një forcë me përfaqësim më të drejtë dhe më mirë të trajnuar. Tani koalicioni qeverisës duhet të rregullojë ligjet që kanë të bëjnë me rajonet e policisë dhe me zgjedhjen e shefave të policisë, implementimin e këtyre ligjeve si dhe të punojë me bashkësinë ndërkombëtare, veçanërisht me PSBE-në dhe EUPAT-in, që të bëjë hapat tjerë të nevojshëm për promovimin e një policie efikase që punon afër me komunitetin.

Reforma e gjyqësorit ka qenë zhgënjyese. Kjo i ka shkuar për shtati qeverisë sepse i ka lejuar që të vazhdojë të ndikojë në punën e gjyqeve. Por, Maqedonia tani është në pikën kur përparimi në sektorët kryesorë – përfshirë zhvillimin ekonomik, iniciativat për anti-korrupsion dhe polici – janë në rrezik. Avis-i është shtytës i rëndësishëm por manovrimet e qeverisë rreth amendamenteve kushtetuese nuk japin arsye për të besuar shumë në motivet dhe përkushtimin e saj. Përparimi i vonuar në reformat e gjyqësorit janë edhe simptomë e mungesës së vëmendjen së bashkësisë ndërkombëtare që duhet të bëjë më tepër se sa të ndërmarrë iniciativa *ad-hoc* dhe të përpilojë një strategji që e komplementon atë të qeverisë.

Nëse Maqedonia nuk ia del të realizojë me sukses reformat në polici dhe në gjyqësi, qeveria nuk rrezikon vetëm kandidaturën për anëtarësim në BE por rrezikon edhe të humbasë aftësinë e vet që të reagojë me efikasitet kundër krizave politike, dashakeqësve dhe armiqëve. Historia e vonë, përfshirë edhe referendumin e vitit 2004 dhe rastin e Kondovës⁷⁴ – tregon se sa e brishtë është gjendja. Në

këtë vit, kontesti në komunitetin islamik, thashethemet për kërcënimin vahabit, kthimi i rasteve nga TPNJ-ja dhe “ambiguiteti konstruktiv” rreth ligjit për amnisti janë raste që mund të shfrytëzohen nga rivalët. Paralelisht me implementimin e ditëpërditshëm të reformave në polici dhe në gjyqësor, qeveria duhet të zhvillojë edhe strategjitë për të evituar këto dhe sfidat tjera, para se këto të eskalojnë në kriza.

Evoluimi i Maqedonisë nga një vend buzë konfliktit të përgjithshëm në kandidatin për anëtarësim në BE është shënuar me tragjedi, është kërcënuar nga dashakeqës dhe njollosur me mosefikasiteti. Megjithatë, me mbështetje të vazhdueshme ndërkombëtare, ia ka arritur që të bëjë hapa përpara, përkundër paqartësive të përhershme në fqinjësi. Një vit pas vendimit strategjik të SHBA-së që të njohë vendin me emrin e vet zyrtar “Maqedoni”, në nëntor 2004, dhe në hovin më të madh të implementimit të marrëveshjes paqësore, *avisi* i BE-së gjallëron një jetë të re në strategjitë e qeverisë për reforma. Me mbështetjen dhe iniciativat politike, tani i takon lidërshpit politik që të vendosë nëse vendi do të çapitë me hapa të pasigurta apo do të marshojë me konfidencë drejt Evropës.

Shkup/Bruksel, 12 Janar 2006

⁷³ Kjo ka ndodhur përkundër spekulimeve të papërgjegjshme të Arben Xhaferit, lider i PDSH-së (parti politike më e vogël e shqiptarëve) për krijimin e Shqipërisë së Madhe. Zyrtarë të qeverisë maqedone, nga të dy grupet etnike më të mëdha, janë të bashkuara rreth dëshirës për zgjidhje të shpejtë dhe paqësore të çështjes së Kosovës që do të siguronte kufijtë e Maqedonisë.

⁷⁴ Shih Brifingun për Evropë të Grupit të Krizave numër 37: *Macedonia: Not Out Of The Woods Yet*, (Maqedonia: Ende në tokë të panjohur), 25 shkurt 2005. Kah mesi i vitit 2004, koalicioni qeverisës filloi negociatat e brendshme rreth legjisllacionit për rridefinimit të kufijve të komunave, element kritik në Marrëveshjen paqësore të Ohrit. Kur negociatat u bënë më të vështira, krahu që kundërshtonte ndërrimet u bë bashkë

me Kongresin Botëror Maqedonas dhe me sukses mblodhën mjaftë nënshkrime për të mbajtur referendum për ligjin e propozuar. Opozita shfrytëzoi fushatën para referendumit që të vejë në pyetje punën e qeverisë si dhe arsyeshmërinë e ndarjes së pushtetit ndërmjet komuniteteve etnike. Vetëm dy javë para referendumit të 7 nëntorit 2004, një grup i vogël i njerëzve të armatosur u paraqit në fshatin Kondovë, fshat shqiptar në kodrat në veri-perëndim të Shkupit. Edhe pse nuk lëshuan ndonjë komunikatë apo kërkesa tjera, grupi i armatosur u kërcënuar me dhunë nëse referendumi do të kalonte. Tensionet mbetën të larta deri sa erdhi vendimi strategjik i SHBA-së që të njohë vendin me emrin kushtetues “Republika e Maqedonisë” e jo sipas emrit të përkohshëm në të cilin insiston Greqia “Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”, duke ndihmuar që të ulen tensionet ndër votuesit. Referendumi dështoi dhe ka mesi i dhjetorit 2005, grupi i armatosur është çarmatosur pa zhurmë.

SHTOJCA A

HARTË E MAQEDONISË

